



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.24

24 mars

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 120, datë 22.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 33, datë 19.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për procedurën e shqyrtimit, nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” 1233
Vendim i KM nr. 121, datë 22.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 469, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve””, të ndryshuar..... 1234
Vendim i KM nr. 122, datë 22.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 184, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”” 1235
Vendim i KM nr. 123, datë 22.2.2012	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Katarit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve..... 1238

Vendim i KM nr. 126, datë 22.2.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kala e Dodës, të qarkut të Dibrës.....	1245
Vendim i KM nr. 128, datë 22.2.2012	Për miratimin e raportit vjetor për ecurinë e procesit të kompensimit financiar të subjekteve të shpronësuara, për vitin 2011.....	1246
Vendim i KM nr. 129, datë 22.2.2012	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.....	1250
Vendim i KM nr. 131, datë 22.2.2012	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore-Shkodër.....	1254
Vendim i KM nr. 132, datë 22.2.2012	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe dru frutorë) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë).....	1256
Vendim i KM nr. 133, datë 22.2.2012	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Ploçë.....	1259
Vendim i KM nr. 134, datë 22.2.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Institutin e Statistikave, për organizimin dhe zbatimin e regjistrimit të njësive ekonomike bujqësore.....	1260
Vendim i KM nr. 135, datë 22.2.2012	Për mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.....	1261

VENDIM
Nr. 120, datë 22.2.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 33, DATË 19.1.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT, NGA KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK, TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË ANKANDIT APO VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 42/1 të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 33, datë 19.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas nenit 2 “Përkufizime”, të kreut I, shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.”.

2. Neni 10 “Rregulla të përgjithshme procedurale” i kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Rregulla të përgjithshme

1. Për çdo çështje të ankimuar, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator një nga anëtarët e tij, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet anëtarëve.

2. Për çështje të ankimuar, me vlerë fillestare më të lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator tre nga anëtarët, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet tyre. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.

3. Rregullat për njohjen me aktet, për përjashtimin e kryetarit, anëtarëve, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, në kushtet kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit, si dhe për pjesëmarrjen dhe detyrat e inspektorëve në shqyrtimin e një ankimi sipas ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e prokurimit publik.”.

3. Në pikën 1 të nenit 18 “Përmbajtja e vendimit”, të kreut II, pas fjalëve “... vulën e Komisionit ...” shtohen fjalët “... anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundër ...” dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose konkurrues t’i bashkëlidhet vendimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 121, datë 22.2.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 469, DATË 16.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË KONCESIONIT APO TË VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË KONCESIONEVE””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 24/1 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 469, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas nenit 2 “Përkufizime”, të kreut I, shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e komisionit

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.”.

2. Neni 8 “Rregulla të përgjithshme procedurale”, i kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Rregulla të përgjithshme

1. Për çdo çështje të ankimuar, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator tre nga anëtarët, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet tyre.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.

2. Rregullat për njohjen me aktet, përjashtimin e kryetarit, anëtarëve, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, në kushtet kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit, si dhe për pjesëmarrjen dhe detyrat e inspektorëve në shqyrtimin e një ankimi sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e prokurimit publik.”.

3. Në pikën 1 të nenit 14 “Përmbajtja e vendimit”, të kreut II, pas fjalëve “... vulën e Komisionit ...” shtohen fjalët “... anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundër ...” dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose konkurrues t’i bashkëlidhet vendimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 122, datë 22.2.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 184, DATË 17.3.2010 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK” DHE
PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 659, DATË 3.10.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK, ME MJETE ELEKTRONIKE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 19/6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 184, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas nenit 2 “Përkufizime”, të kreut I, shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me akte të tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.”.

2. Në pikën 1 të nenit 4 “Organizimi i Komisionit”, të kreut II, fjalët “... në varësi të Këshillit të Ministrave ...” zëvendësohen me fjalët “... në varësi të Kryeministrit...”.

3. Në shkronjën “e” të pikës 1 të nenit 6 “Kompetencat e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit”, të kreut II, emërtimi “... Këshilli i Ministrave ...” zëvendësohet me “...Kryeministri ...”.

4. Pas shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 6 “Kompetencat e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit”, të kreut II, shtohet shkronja “f/1”, me këtë përmbajtje:

“f/1) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e rregullores së brendshme.”.

5. Pas nenit 6 “Kompetencat e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit”, të kreut II, shtohet neni “6/1”, me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit

1. Anëtarët marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit.

2. Anëtari i Komisionit ka të drejtë, të paktën dy ditë përpara relativitetit të çështjes, të informohet dhe të disponojë kopje të projektvendimit dhe dokumentacionin në lidhje me të, si dhe të njihet me rendin e ditës së mbledhjes së radhës.

3. Anëtari i Komisionit ka të drejtë të kërkojë mbajtjen e rregullt dhe të plotë të procesverbalit të mbledhjes. Kopja e zbardhur e procesverbalit i vihet në dispozicion për nënshkrim jo më vonë se dy ditë.

4. Në çdo rast, anëtari i Komisionit ka të drejtë të paraqesë, në mbledhjen e Komisionit, për diskutim dhe vendimmarrje, çështje që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen, funksionimin dhe stafin mbështetës të këtij Komisioni.

5. Anëtari relator i çështjes, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, ka detyrimin të sigurohet që secilit anëtar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni i plotë i çështjes.

6. Anëtari i Komisionit, kur e gjykon të nevojshme gjatë shqyrtimit të çështjes, ka të drejtë t’u kërkojë palëve paraqitjen përpara tij dhe/ose Komisionit apo inspektorëve me qëllim zhvillimin e seancave dëgjimore, përmbajtja e të cilave duhet të pasqyrohet në procesverbal.”.

6. Pas pikës 3 të nenit 7 “Inspektorët dhe personeli ndihmës”, të kreut II, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4) Inspektorët e Komisionit ushtrojnë funksionet e mësipërme në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.”.

7. Pas nenit 9 “Marrëdhëniet me të tretët”, të kreut II, shtohet neni 9/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Rendi i ditës

1. Mbledhja e Komisionit zhvillohet në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

2. Kryetari i Komisionit e, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, vendos për rendin e ditës, duke mbajtur parasysh njoftimet, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje. Në rendin e ditës duhet të përfshihen çështjet e propozuara nga anëtarët e Komisionit, sipas pikës 3 të këtij neni, si dhe çdo çështje tjetër në kompetencë të tij.

3. Njoftimi i anëtarit relator drejtuar kryetarit për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 (tre) ditë përpara thirrjes së mbledhjes.

4. Rendi i ditës duhet t’u njoftohet me shkrim anëtarëve të Komisionit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje.”.

8. Në nenin 10 “Mbledhjet dhe votimi”, të kreut II, bëhen këto shtesa:
- Në pikën 1 pas fjalëve “... merr masat ...” shtohen fjalët “..duke njoftuar me shkrim ..”.
 - Në pikën 3, pas fjalëve “... mbi bazë dokumentesh ...” shtohen fjalët “... siç parashikohet në pikën 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje ...”.
 - Në fund të pikës 3, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Anëtarët e Komisionit dhe inspektorët, që kanë pengesë ligjore, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimit, diskutimit dhe votimit të çështjes.”.
 - Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:
“6) Gjatë zhvillimit të mbledhjes respektohen, por pa u kufizuar në to, rregullat e mëposhtme:
 - Respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e mbledhjes nga anëtarët;
 - Respektimi i rendit të ditës dhe qetësisë gjatë zhvillimit të mbledhjes;
 - Respektimi i kohës në dispozicion të anëtarëve pjesëmarrës për të parashtruar qëndrimin e tyre të ndryshëm, nëse ka, e cila përcaktohet nga kryetari përpara fillimit të mbledhjes.
 - Çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mbledhjes.”.
9. Në pikën 2 të nenit 13 “Transparenca e veprimtarisë”, të kreut II, pas fjalëve “... publikohen të plota ...” shtohen fjalët “... duke përfshirë dhe votimin kundër ...”
10. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 14 të kreut II “Raporti mbi veprimtarinë dhe komunikimin e të dhënave”, emërtimi “... Këshilli i Ministrave...” zëvendësohet me “... Kryeministri...”.
11. Në nenin 20 “Caktimi i çështjeve dhe njohja me aktet”, të kreut III, bëhen këto shtesa:
- Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
“1/1 Për çështje me vlerë të fondit limit më të lartë se kufiri i ulët monetar, çështja i caktohet me short tre anëtarëve. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.”.
 - Në pikën 2, pas fjalëve “... bashkëlidhur asaj ...” shtohen fjalët “... sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1 ...”.
12. Në nenin 21 “Përjashtimi”, të kreut III, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:
- Në pikën 1, pas fjalëve “... anëtar i Komisionit ...” shtohen fjalët “... nuk mund të jetë relator dhe ...”.
 - Në pikën 5, fjalët “... kryetar i Komisionit ...” zëvendësohet me fjalën “... Komisioni ...”.
13. Pika 2 e nenit 22 “Pjesëmarrja dhe detyra e inspektorëve”, të kreut III, shfuqizohet.
14. Në pikën 1 të nenit 29 “Përmbajtja e vendimit”, të kreut III, pas fjalëve “... vulën e Komisionit ...” shtohen fjalët “...anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundër ...” dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:
“Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose paralel t’i bashkëlidhet vendimit.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 123, datë 22.2.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR
NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË
INVESTIMEVE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit të referuara më poshtë si “Palët kontraktuese”;

me dëshirën për të intensifikuar bashkëpunimin ekonomik me përfitim të ndërsjellë për të dyja shtetet;

me qëllim krijimin dhe ruajtjen e kushteve të favorshme për investimet nga investorët e një palë kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese;

duke njohur nevojën e nxitjes dhe mbrojtjes së këtyre investimeve me qëllim nxitjen e prosperitetit ekonomik të të dyja palëve kontraktuese;

duke rënë dakord që trajtimi i paanshëm dhe i drejtë i investimeve është i nevojshëm që të ruhet një kuadër i qëndrueshëm për investimet dhe përdorimin me efektivitet të plotë të burimeve ekonomike,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe, përveç kur përcaktohet ndryshe, fjalët dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet përkatëse:

1. Termi “Investitor” i referohet çdo personi fizik ose juridik të njërës palë kontraktuese:

a) Termi “Person fizik” në lidhje me secilën palë kontraktuese i referohet çdo personi fizik i cili është shtetas i palëve të kësaj Marrëveshjeje.

b) Termi “Person juridik” në lidhje me secilën palë kontraktuese i referohet çdo personi juridik, ndërmarrjeje, kompanie, korporate, firme apo shoqate biznesi, të krijuara apo organizuara

në pajtim me ligjet e zbatueshme të asaj pale kontraktuese dhe që e kanë selinë e tyre në territorin e asaj pale kontraktuese.

Gjithashtu, për shtetin e Katarit “Person juridik” përfshin qeverinë, agjencitë qeveritare, autoritetet, trustet dhe organizatat e krijuara apo organizuara në pajtim me legjislacionin përkatës të Shtetit të Katarit, ose të një pale të tretë në të cilën investitori i përmendur më lart ushtron kontroll efektiv.

Për një investitor që investon në Republikën e Shqipërisë, një “Person juridik” përfshin çdo person juridik që është përfshirë ose caktuar në pajtim me ligjet e një vendi të huaj, i cili i kërkon drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte të kryejë ose është duke kryer një investim në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas ligjeve të saj.

2. Termi “Investim” nënkupton çdo lloj sendi pasuror i investuar nga një investitor i njëjës prej palëve kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese në pajtim me ligjet dhe rregulloret e palës kontraktuese të fundit dhe veçanërisht, megjithëse jo ekskluzivisht, përfshin:

a) pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të drejta të tjera të pronësisë, si servituti, garancia, hipoteka, barra, pengje dhe të drejta të ngjashme;

b) pjesë në aksione dhe detyrime të një shoqërie ose çdo formë tjetër pjesëmarrjeje në një shoqëri;

c) të drejtat për mjete monetare ose për çdo veprim në bazë të kontratës që ka një vlerë ekonomike;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale, siç janë e drejta e autorit, markat, patentat, proceset teknike, dijet teknike dhe reputacioni;

e) koncesionet e biznesit të dhëna me ligj ose në bazë të një kontrate, duke përfshirë koncesionin për kërkimin dhe nxjerrjen dhe shfrytëzimin e burimeve të tjera natyrore.

3. Termi “Të ardhura” nënkupton shumat e parave që jepen nga një investim dhe përfshin veçanërisht, megjithëse jo ekskluzivisht, fitimin, dividendët, interesin, fitimet e kapitalit, honorarët dhe tarifatat.

4. Çdo ndryshim i formës së investimit ose riinvestimit të aseteve nuk cenon cilësimin e investimit si të tillë, me kusht që ky ndryshim i investimit të mos jetë në kundërshtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, apo me legjislacionin e palës kontraktuese në territorin e së cilës kryhen këto investime.

5. “Territori”

a) Për Republikën e Shqipërisë termi “Territor” nënkupton territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë zonën detare dhe ujërat territoriale dhe shelfin kontinental, mbi të cilin Republika e Shqipërisë ushtron sovranitetin e saj dhe të drejtat ligjore, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, si dhe me të drejtën ndërkombëtare.

b) Për Shtetin e Katarit termi “Territor” nënkupton territorin e secilës palë kontraktuese, duke përfshirë tokën, ujërat e brendshme dhe ujërat territoriale të tyre duke përfshirë shtratin e tij, shtresën tokësore nën ujë dhe hapësirën ajrore mbi to, zonën ekonomike ekskluzive dhe shelfin kontinental, mbi të cilat secila palë kontraktuese ushtron të drejtat e veta sovrane dhe juridiksionin, në pajtim me dispozitat e së drejtës ndërkombëtare, si dhe me ligjet dhe rregulloret e brendshme të tyre.

Neni 2

Fusha e veprimit të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjithë investitorët dhe investimet e bëra nga investitorë të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese, të pranuar si të tillë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, qofshin të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje apo pas saj, por nuk do të zbatohet për mosmarrëveshje të lindura përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Secila palë kontraktuese inkurajon dhe krijon kushte të favorshme për investitorët e palës tjetër kontraktuese për të bërë investime në territorin e saj dhe t'i pranojë këto investime në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj në fuqi.

2. Kur një palë kontraktuese pranon një investim në territorin e saj, ajo do të japë lejet e nevojshme në lidhje me këtë investim dhe do të zbatojë marrëveshjet për licencim dhe kontrata për asistencë administrative, tregtare dhe teknike, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj. Secila palë kontraktuese, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, sa herë është e nevojshme, do të përpiqet të lëshojë autorizimet e domosdoshme në lidhje me aktivitetet e këshilltarëve dhe personave të tjerë të kualifikuar me kombësi të huaj.

3. Investimeve të bëra nga investitorët e çdo pale kontraktuese u jepet gjithmonë një trajtim i drejtë dhe i paanshëm dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë, në territorin e palës tjetër kontraktuese.

4. Asnjë palë kontraktuese nuk do të cenojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masave të paarsyeshme dhe diskriminuese veprimtarinë, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin ose shitjen e investimit në territorin e saj nga investitorët të palës tjetër kontraktuese.

Neni 4

Trajtimi i investimit

1. Secila palë kontraktuese u jep në territorin e saj investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të palës tjetër kontraktuese një trajtim që është i drejtë dhe i paanshëm dhe nuk është më pak i favorshëm se ai që u jepet investimeve dhe të ardhurave të veta apo investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të një shteti të tretë, cilado qoftë më e favorshme për investitorin.

2. Secila palë kontraktuese u jep në territorin e saj investitorëve të palës tjetër kontraktuese, në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin ose shitjen e investimit, një trajtim që është i drejtë dhe i paanshëm dhe nuk është më pak i favorshëm se ai që u jepet investitorëve të saj të vet.

3. Secila palë kontraktuese u jep në territorin e saj investitorëve të palës tjetër kontraktuese, një trajtim që nuk është më pak i favorshëm se ai që u jepet investitorëve të një pale të tretë.

4. Trajtimi i dhënë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk interpretohet sikur detyron një palë kontraktuese t'i ofrojë investitorëve të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tyre përfitimet e çdo trajtimi, preference ose privilegji që rezultojnë nga:

a) anëtarësimi i tij në, ose lidhja me çdo zonë ekzistuese ose të ardhshme të tregtisë së lirë, bashkim doganor, treg ekonomik, i përbashkët, ose bashkim monetar ose marrëveshje të tjera ndërkombëtare të ngjashme, duke përfshirë forma të tjera të organizimit ekonomik rajonal, ose

b) çdo marrëveshje ndërkombëtare ose masë që lidhet tërësisht ose kryesisht me taksimin, apo çdo ligj të brendshëm që lidhet tërësisht ose kryesisht me taksimin.

5. Nëse legjislacioni i brendshëm i një palë kontraktuese, ose detyrimet sipas të drejtës ndërkombëtare ekzistuese në këtë moment, ose të vendosura që këtej e tutje ndërmjet palëve kontraktuese, si shtesë e kësaj Marrëveshjeje, përmban një normë, qoftë ajo e përgjithshme ose e veçantë, e cila u jep investimeve nga investitorët e palës tjetër kontraktuese të drejtën e një trajtimi më të favorshëm se sa parashikohet nga kjo Marrëveshje, kjo normë në masën që është më e favorshme, do të mbizotërojë mbi këtë Marrëveshjeje.

6. Sa herë që trajtimi i dhënë nga një palë kontraktuese për investitorët e palës tjetër kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj ose dispozitat e tjera të kontratës së veçantë ose të autorizimit apo marrëveshjes për investime, është më e favorshme se ajo e parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet trajtimi më i favorshëm.

Neni 5

Shpronësimi dhe kompensimi

1. Asnjë nga palët kontraktuese nuk do të marrë masa për shpronësimin, shtetëzimin ose çdo masë tjetër që ka efekt të ngjashëm ndaj investimeve që i përkasin investitorëve të palës tjetër kontraktuese (më poshtë “shpronësimi”), përveç kur masat merren në interes të publikut, mbi baza jodiskriminuese dhe sipas një procesi të rregullt ligjor dhe kundrejt pagimit të kompensimit të përshtatshëm dhe efektiv. Ky kompensim llogaritet sa vlera e tregut për investimin e shpronësuar, menjëherë përpara se shpronësimi ose shpronësimi i ndaluar të bëhet i njohur për publikun, cilado qoftë më e hershme (më poshtë “data e vlerësimit”).

2. Kjo vlerë tregu shprehet në një vlerë monetare të përdorur lirisht sipas zgjedhjes së investitorit, me kursin e këmbimit valutor të tregut, që ka kjo monedhë në datën e vlerësimit. Kompensimi duhet të paguhet pa vonesë, të jetë efektivisht i realizueshëm dhe i transferueshëm në një monedhë valutore të përdorur lirisht të përcaktuar sipas zgjedhjes së investitorit. Kompensimi përfshin gjithashtu interesin e llogaritur në bazë të normës LIBOR gjashtëmujore që nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës.

3. Nëse një palë kontraktuese shpronëson sendet pasurore të shoqërisë që është përfshirë apo themeluar në bazë të ligjit në fuqi në çdo pjesë të territorit të vet dhe në të cilin investitorët e palës tjetër kontraktuese zotërojnë aksione, ajo siguron që dispozitat e këtij neni të zbatohen në mënyrë që të garantojnë një kompensim të përshtatshëm dhe efektiv në lidhje me investimin e tyre për këta investitorë të palës tjetër kontraktuese që janë pronarë të atyre aksioneve.

4. Investitorëve të një pale kontraktuese, të cilët pësojnë humbje të investimeve të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese për shkak të luftës apo një konflikti tjetër të armatosur, gjendjes kombëtare të jashtëzakonshme, revoltave, rebelimeve dhe trazirave, u jepet, në lidhje me kthimin, dëmshpërblimin, kompensimin ose shlyerje të tjera, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet investitorëve të vet ose investitorëve të ndonjë shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshëm për investitorin.

Pagesat që rrjedhin prej saj, do të transferohen pa vonesë, në një monedhë valutore të konvertueshme dhe të përdorur lirisht sipas zgjedhjes së investitorit.

Neni 6

Transferimi

1. Secila palë kontraktuese lejon të gjitha fondet dhe të ardhurat e një investimi të palës tjetër kontraktuese, në lidhje me një investim në territorin e saj të transferohen dhe eksportohen lirisht, pa vonesë dhe mbi një bazë jodiskriminuese. Këto fonde do të përfshinin:

- a) kapitalin dhe shumat shtesë të kapitalit të përdorura për të ruajtur dhe rritur investimin;
- b) të ardhurat;
- c) shlyerjet e çdo huaje, duke përfshirë interesin mbi to, në lidhje me investimin;
- d) të ardhurat nga shitjet e aksioneve të tyre;
- e) të ardhurat e marra nga investitorët, në rastin e shitjes ose shitjes së pjesshme, ose likuidimit;
- f) të ardhurat e personave fizikë të një pale kontraktuese apo të personelit që vjen nga jashtë, të cilët punojnë në lidhje me një investim në territorin e palës tjetër kontraktuese;
- g) pagesat që rrjedhin nga një mosmarrëveshje mbi investimin;
- h) kompensimi në bazë të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje.

2. Transferimet sipas kësaj marrëveshjeje do të bëhen pa vonesë, në valutën fillestare ose në një valutë tjetër lirisht të përdorshme, sipas zgjedhjes së një investitori, në kursin e këmbimit të tregut të zbatueshëm në datën e transferimit.

3. Palët kontraktuese për transferimet janë dakord që sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, të japin një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u sigurohet transferimeve të të ardhurave nga investimet e bëra nga një shtet i tretë.

Neni 7 **Zëvendësimi**

1. Nëse një palë kontraktuese apo agjencia e caktuar prej saj ka garantuar një zhdëmtim ndaj rreziqeve jotregtare në lidhje me një investim nga një prej investitorëve të saj në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe u ka bërë pagesën këtyre investitorëve në lidhje me pretendimet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje, pala tjetër kontraktuese bie dakord që pala e parë kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj kanë të drejtë që në bazë të zëvendësimit të ushtrojë të drejtat dhe të ngrejë pretendimet e këtyre investitorëve. Të drejtat ose pretendimet e zëvendësuar nuk i tejkalojnë të drejtat ose pretendimet fillestare të këtyre investitorëve.

2. Në rastin e zëvendësimit, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni investitori nuk do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime, nëse nuk autorizohet nga pala tjetër kontraktuese ose nga agjencia e saj e caktuar.

Neni 8 **Mohimi i fitimeve**

Pas njoftimit, njëra palë kontraktuese mund t'i mohojë fitimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje:

1. Një investitori të pala tjetër kontraktuese i cili është person juridik i kësaj pale kontraktuese dhe një investim të këtij investitori, në rastin kur ky person juridik zotërohet ose kontrollohet nga investitorët e një pale të tretë dhe pala kontraktuese që mohon fitimet nuk ruan marrëdhënie diplomatike me palën e tretë.

2. Një investitori të palës tjetër kontraktuese, i cili është person juridik i kësaj të fundit dhe investimit të atij investitori, nëse një investitor i një pale jokontraktuese zotëron ose kontrollon personin juridik dhe ky i fundit nuk ka veprimtari biznesi në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 9 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet një pale kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese**

1. Çdo mosmarrëveshje ligjore në bazë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, që rrjedh drejtpërdrejt nga një investim ndërmjet një pale kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre.

2. Nëse këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni brenda gjashtë muajsh nga data e kërkesës me shkrim për zgjidhje, investitori përkatës mund t'i paraqesë mosmarrëveshjen për zgjidhje, sipas zgjedhjes së vet:

a) gjykatës kompetente të palës kontraktuese pritëse për vendim; ose

b) Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve, të ngritur në bazë të Konventës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera të datës 18 mars 1965, bërë në Washington D.C., nëse kjo Konventë është e zbatueshme për palët kontraktuese; ose

c) një gjykatë të posaçme arbitrazhi.

Pasi investitori të ketë zgjedhur një nga mënyrat e lartpërmendura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ai nuk mund të zgjedhë dy mënyrat e tjera.

3. Gjykata e posaçme e arbitrazhit e parashikuar sipas paragrafit 2 (c) ngrihet si më poshtë:

i) Secila palë e mosmarrëveshjes emëron një arbitër, dhe të dy arbitrat e emëruar zgjedhin me marrëveshje reciproke një arbitër të tretë, që duhet të jetë një shtetas i një vendi të tretë, dhe që vepron si Kryetar i Gjykatës. Të gjithë arbitrat duhet të emërohen brenda dy muajve nga data e njoftimit të një pale nga pala tjetër në lidhje me synimin e saj për t'ia paraqitur mosmarrëveshjen arbitrazhit.

ii) Nëse periudhat e parashikuara në paragrafin 3 (a) në këtë marrëveshje nuk janë respektuar, secila palë, në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, fton Sekretarin e Përgjithshëm ose Nënsekretarin e Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë për të bërë emërimet e nevojshme.

iii) Gjykata e posaçme e arbitrazhit merr vendimin e saj me shumicë votash. Këto vendime janë të formës së prerë dhe ligjërisht detyruese për palët dhe zbatohen në pajtim me ligjin e brendshëm të palës kontraktuese të mosmarrëveshjes. Vendimet merren në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe ligjeve të palës kontraktuese të mosmarrëveshjes dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga Gjykata, në përputhje me rrethanat e veçanta, secila palë e mosmarrëveshjes përballon vetë kostot e përfaqësimit në procedimet e arbitrazhit; kostot e arbitrave dhe të gjitha kostot e mbetura do të përballohen në pjesë të barabarta nga palët e mosmarrëveshjes.

iv) Gjykata e interpreton vendimin e saj dhe jep arsyet dhe faktet e vendimit të saj, me kërkesë të secilës palë. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga palët, vendi i arbitrazhit është selia e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë (Holanda).

Sa më sipër, Gjykata respekton Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën ndërkombëtare tregtare (UNCITRAL), 1976.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese

1. Të dyja palët kontraktuese përpiqen me mirëbesim dhe bashkëpunim të ndërsjellë për të arritur një zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë për çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet tyre në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Në këtë kontekst, të dyja palët kontraktuese bien dakord të hyjnë në bisedime të drejtpërdrejta objektive për të arritur një zgjidhje të tillë. Nëse mosmarrëveshja nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën çështja është ngritur nga një palë kontraktuese, ajo mund t'i paraqitet me kërkesë të çdo pale kontraktuese, një Gjykatë Arbitrazhi që përbëhet nga tre anëtarë.

2. Brenda një periudhe prej dy muajsh nga data e marrjes së kësaj kërkesë, secila palë kontraktuese emëron një arbitër dhe të dy arbitrat e emëruar, brenda një periudhe prej dy muajsh dhe me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese, emërojnë një shtetas të një vendi të tretë si Kryetar të Gjykatës.

3. Nëse brenda periudhave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila palë kontraktuese, në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, mund të ftojë Kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse Kryetari është shtetas i një pale kontraktuese ose ndryshe pengohet të përmbushë këtë funksion, Zëvendëskryetari ftohet të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse Zëvendëskryetari është shtetas i një pale kontraktuese, apo nëse edhe ai pengohet të përmbushë këtë funksion, Anëtarin më të vjetër të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që nuk është shtetas i një pale kontraktuese ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

4. Gjykata e Arbitrazhit merr vendimet e saj me shumicë votash. Këto vendime janë të formës së prerë dhe detyruese për të dyja palët kontraktuese. Secila palë kontraktuese përballon shpenzimet për anëtarin e vet të gjykatës dhe përfaqësimin e saj në procedimet e arbitrazhit;

shpenzimet e kryetarit dhe shpenzimet e tjera të përballohen në pjesë të barabarta nga palët kontraktuese. Megjithatë, Gjykata mund të vendosë se një përqindje më e lartë e shpenzimeve do të përballohet nga njëra prej dy palëve kontraktuese dhe ky vendim është detyrues për të dyja palët kontraktuese, gjykata përcakton procedurat e veta.

5. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët kontraktuese, vendi i arbitrazhit do të jetë selia e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë, Holandë.

6. Të gjitha pretendimet paraqiten dhe të gjitha seancat përfundojnë brenda një periudhe prej tetë muajsh nga data e emërimit të anëtarit të tretë, nëse nuk bihet dakord ndryshe. Gjykata e nxjerr vendimin e saj brenda dy muajve nga data e paraqitjes së pretendimeve përfundimtare ose nga data e mbylljes së sesioneve të përgjithshme, cilado që të jetë më e vonshme.

7. Nuk lejohet që mosmarrëveshja t'i paraqitet një gjykate arbitrazhi sipas dispozitave të këtij neni, nëse kjo mosmarrëveshje i është paraqitur një gjykate tjetër arbitrazhi në pajtim me dispozitat e nenit 8 sipas kësaj marrëveshjeje dhe që vazhdon të shqyrtohet nga ajo gjykatë.

Neni 11

Hyrja dhe qëndrimi i personelit

Një palë kontraktuese, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj të zbatueshme në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin e jostetasve, lejon personat fizikë të palës tjetër kontraktuese dhe personat e tjerë të emëruar apo të punësuar nga investitorët e palës tjetër kontraktuese për të hyrë dhe qëndruar në territorin e saj, me qëllim përfshirjen në aktivitetet që lidhen me investimet.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje apo çdo amendim i mëvonshëm do të hyjë në fuqi në datën më të vonshme kur secila palë kontraktuese njofton palën tjetër për përmbushjen e kërkesave të brendshme ligjore, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje apo amendimet e saj.

2. Kjo Marrëveshje mund të amendohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet dy palëve kontraktuese.

Neni 13

Kohëzgjatja dhe denoncimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dhjetë vjetësh dhe do të vazhdojë të mbetet në fuqi më pas për një periudhë ose periudha të ngjashme, nëse një vit përpara përfundimit të periudhës fillestare ose çdo periudhe të mëvonshme, njëra palë kontraktuese njofton palën tjetër kontraktuese në lidhje me synimin e saj për të denoncuar Marrëveshjen.

Njoftimi për denoncimin e marrëveshjes hyn në fuqi një vit pasi të jetë marrë nga pala tjetër kontraktuese.

2. Në lidhje me investimet e bëra përpara datës kur njoftimi mbi denoncimin e kësaj marrëveshjeje ka hyrë në fuqi, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një periudhë prej dhjetë vjetësh nga data e denoncimit të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 18 tetor 2011, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr. 126, datë 22.2.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KALA E DODËS, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kala e Dodës, të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kala e Dodës, të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 701, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kala e Dodës, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kala e Dodës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kala e Dodës, Dibër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
9, 11-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në përdorim
13-17,19-20,23	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
50,52,54,56,58,60,62,64	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
51,53,55,57,59,61,63,65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr. 128, datë 22.2.2012

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR ECURINË E PROCESIT TË
KOMPENSIMIT FINANCIAR TË SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA, PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor për ecurinë e procesit të kompensimit financiar të subjekteve të shpronësuara, për vitin 2011, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë, që brenda muajit mars 2012, të paraqesë raportin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORT
**PËR ECURINË E PROCESIT TË KOMPENSIMIT NË TË HOLLA PËR SUBJEKTET E
SHPRONËSUARA NË VITIN 2011**

I. Hyrje

E drejta e pronës është njëra prej të drejtave kushtetuese themelore që i është njohur individëve. Gëzimi i kësaj të drejte nga ana e individëve, është një prej premisave kryesore për zhvillimin e personalitetit të tyre, mirëqenies së shoqërisë duke kontribuar në zhvillimin dhe funksionimin e ekonomisë së një vendi. Vizioni i Qeverisë Shqiptare në realizimin e reformës së të drejtave të pronës synon rregullimin e tregut të tokës, pronës, në funksion të zhvillimit ekonomik për ta shndërruar Shqipërinë në një vend më të zhvilluar.

Parimet që udhëheqin respektimin e së drejtës së pronës janë të dimensionit kushtetues dhe kanë të bëjnë me interesin publik, shpërblimin e drejtë, parimin e drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social, duke u bazuar jo vetëm në elaborimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe parimet e sigurisë juridike dhe të qartësisë së legjislacionit, si premisa thelbësore të forcimit të të drejtave themelore paralelisht me zhvillimin e vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Në këtë aspekt, procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, në funksion të garantimit dhe ushtrimit të së drejtës së pronës.

Në bazë të nenit 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe në zbatim të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, është krijuar Fondi i Kompensimit të Pronave, fond i cili përdoret për kompensimin në vlerë të subjekteve të shpronësuara, të cilëve iu është njohur e drejta e kompensimit, kur kthimi fizik i pronës ka qenë i pamundur. Ky ligj, për herë të parë në legjislacionin shqiptar, njohu kompensimin në të holla si formë kompensimi dhe synon realizimin në shkallë gjithnjë e më të lartë të këtij procesi të rëndësishëm për Shqipërinë dhe për stabilizimin e ekonomisë shqiptare.

Fondi i kompensimit të pronave përveçse përbëhet nga të ardhurat buxhetore, parashikon edhe kontributin e të ardhurave të tjera të krijuara me ligj, siç mund të jenë, të ardhurat e realizuara nga shitja me ankand e pasurive shtetërore, për të cilat nuk ka vendim të dhënë nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe të ardhura nga donatorë të ndryshëm për këtë qëllim.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, i cili parashikon se:

“1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë, për ecurinë e procesit të kompensimit financiar dhe për administrimin e fondit të kompensimit të pronave.

2. Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, raporton në Kuvend brenda muajit mars të çdo viti për ecurinë e procesit të kompensimit financiar”.

Në këtë aspekt, Këshilli i Ministrave nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, plotëson detyrimin për paraqitjen e raportimit përpara kuvendit, në lidhje me ecurinë e procesit të kompensimit financiar të subjekteve të shpronësuara, gjatë vitit kalendarik 2011.

II. Administrimi i fondit të kompensimit në të holla

Në lidhje me administrimin e fondit të kompensimit financiar, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga neni 11, shkronja “d” dhe neni 17 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe në bazë të dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 13.4.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, është përcaktuar Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, si institucioni i cili administron fondin e kompensimit të pronave për subjektet e shpronësuara.

Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, pas propozimit të AKKP-së, është proceduar me hartimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, të pronarëve, në të holla, për vitin 2011”, në mënyrë që të realizohej shpërndarja e fondit dhe akordimi i masës së kompensimit të ish-pronarëve për këtë vit. Projektvendimi në fjalë, është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 9.3.2011, me vendimin nr. 192, datë 9.3.2011.

Këtu gjejmë rastin për të evidentuar faktin që gjatë hartimit të këtij projektvendimi, u morën në konsideratë ndryshimet e fundit ligjore dhe strukturore të Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, si dhe u mbajtën parasysh konstatimet e gjetura nga ana e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për krijimin e një skeme të re kompensimi.

Nëpërmjet miratimit të vendimit të sipërpërmendur, u parashikuan ndryshimet e nevojshme që kishin për qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- Eliminimin e kriterëve të tepërta skualifikuese të metodës së mëparshme;
- Rritjen e masës së kompensimit të pronës, në proporcion me sipërfaqen e njohur për kompensim;
- Thjeshtimin e procedurave për përfitimin e kompensimit në të holla nga ana e subjekteve të shpronësuara.

III. Ecuria e procesit të kompensimit në të holla të subjekteve të shpronësuara për vitin 2011

Sipas përvijimit të procesit të kompensimit në të holla për subjektet e shpronësuara që iu është njohur e drejta e pronësisë vërehet se:

Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave për kompensim financiar nga fondi në të holla për vitin 2011, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 9.3.2011 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, të pronarëve, në të holla, për vitin 2011”, është shtrirë në periudhën e përfshirë nga datat 28.3.2011 deri më 27.4.2011, sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 8 të këtij vendimi “Procesi i regjistrimit/pranimit të

kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 1 (një) muaj”.

Gjatë kësaj periudhe, pranë AKKP-së janë regjistruar gjithsej 1012 aplikime/kërkesa për kompensim financiar. Të gjitha kërkesat e paraqitura pranë AKKP-së, krahas administrimit në regjistrin e protokollit (manual), janë hedhur edhe në regjistrin elektronik, sipas një formati të detajuar.

Shpërndarja e kompensimit në të holla nga Fondi i Kompensimit për vitin 2011, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 9.3.2011, ka përfunduar më datë 15.8.2011.

Pas vlerësimit të 1012 aplikimeve/kërkesave për kompensim financiar, janë pranuar kërkesat nga 107 subjekte të shpronësuara duke u trajtuar me kompensim në të holla dhe janë rrëzuar kërkesat e 46 subjekteve të shpronësuara, për të cilat janë zbardhur vendimet përkatëse.

Lidhur me 859 aplikuesit e tjerë për këtë proces, nga ana e AKKP-së është proceduar, gjithashtu, me zbardhjen dhe njoftimin e vendimeve subjekteve të shpronësuara, se për pamjaftueshmëri fondesh këto subjekte do të kompensohen në vitin 2012.

Shuma totale e shpërndarë, gjatë këtij procesi për 107 subjektet përfituese ishte 665 999 275 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Janë ekzekutuar gjithashtu, vendimet gjyqësore, për të cilat ishin lëshuar urdhrat e ekzekutimit, në lidhje me kompensimin në të holla për katër subjekte të shpronësuara për shumën totale prej 13 715 000 lekë, subjekte të cilat kishin ankimuar në gjykatë vendimin e AKKP-së për rrëzimin e kërkesës për kompensim.

IV. Procesi i kompensimit (shpërblimi) i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, gjatë vitit 2011

Në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave” dhe të akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave, AKKP-së i është njohur përgjegjësia për shpërndarjen e fondit për legalizimet. Këshilli i Ministrave ka nxjerrë disa akte nënligjore për këtë çështje, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.5.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar, si dhe;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1453, datë 5.11.2008 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 19.2.2009 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 11.6.2009 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1039, datë 14.10.2009 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 19.5.2010 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 17.2.2011 “Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive”.

Këto vendime përcaktojnë jo vetëm procesin e aplikimit nga ana e subjekteve të interesuara, por edhe rregullat sipas të cilave AKKP duhet të procedojë me shpërndarjen e shumave respektive nga ana e AKKP-së.

Për të gjitha aplikimet e pranuar dhe miratuara gjatë periudhës gusht 2010-shkurt 2011, nga ana e AKKP-së, me vendimin nr. 178, datë 7.3.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së është kryer shpërndarja e kështit të dytë në masën 15,05% të shumës totale të kompensimit (shpërblimit) të miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave, të miratuara, rast pas rasti, me qëllim shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive. Pra, deri në datën 21.2.2011 janë shqyrtuar dhe miratuar 52 kërkesa për tërheqjen e kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale në të gjithë vendin.

Gjatë këtij procesi, është shpërndarë shuma prej 89 939 668,10 (tetëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dhjetë) lekë.

Në përfundim të këtij procesi, për kështin e dytë të kompensimit është proceduar me përpunimin e 312 kërkesave të depozituara pranë AKKP-së dhe më pas është shpërndarë shuma e përgjithshme prej 749 028 316,14 (shtatëqind e dyzet e nëntë milionë e njëzetetë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë presje katërmëdhjetë) lekë.

Në datën 6.5.2011 është përfunduar procesi i shqyrtimit të 49 kërkesave për kompensim (shpërblim) të paraqitura rishtas pranë AKKP-së.

Me vendimin nr. 247, datë 6.5.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, është pranuar kërkesa e subjekteve dhe më pas është proceduar me lëvrimin e vlerës respektive në të holla në masën 36,94% të shumës totale të kompensimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në llogaritë bankare të depozituara paraprakisht nga subjektet e interesuara në AKKP dhe është shpërndarë shuma e përgjithshme prej 56 862 184,76 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

Me vendimin nr. 1303, datë 18.11.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, është proceduar me shpërndarjen e kështit të parë dhe të dytë nga fondi i ALUIZNI-t, për 43 kërkesa të tjera në shumën prej 117 864 528,14 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e tetë presje katërmëdhjetë) lekë.

Me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, nr. 1380, datë 16.12.2011 për 88 kërkesa është shpërndarë shuma totale prej 268 938 499,10 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë presje dhjetë) lekë.

Së fundmi, me vendimin nr. 1399, datë 23.12.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, është shpërndarë gjithashtu edhe kështi i tretë për 509 kërkesa/aplikime, të cilat kanë përfutuar shumën totale prej 594 459 432,63 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e dy presje gjashtëdhjetë e tre) lekë.

Sa më sipër shuma totale e shpërndarë ndaj pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale është 1 877 092 628,87 (një miliard e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë.

E gjithë kjo shumë është kaluar në Fondin Special të Kompensimit të Pronarëve nga ALUIZNI, në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave".

V. Përfundime

Në përfundim të këtij raportimi, konkludojmë se procesi i kompensimit të pronave është kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të plotë të parimeve të transparencës dhe të miradministrimit të fondit të kompensimit të pronave. Procesi i kompensimit në të holla dhe administrimi i fondit special për kompensimet janë duke vazhduar rregullisht sipas parashikimeve.

Gjithashtu, konkludohet se procesi i kompensimit në të holla është orientuar sipas parimeve të kompensimit të drejtë, të parimit të barazisë para ligjit të subjekteve në kushte të ngjashme, të parimit të sigurisë juridike, të parimit të procesit të rregullt ligjor, të parimit të proporcionalitetit. Nga ecuria e këtij procesi, evidentohet se të dhënat janë optimiste në konsolidimin dhe administrimin e procesit të kompensimit në të holla të pronarëve.

Duke marrë shkas për nga vetë rëndësia e këtij procesi, kjo çështje do të jetë në vëmendjen e shtuar dhe konstante të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, sepse lidhet ngushtë jo vetëm me të drejtën e pronësisë, si një prej të drejtave themelore, por edhe sepse kjo çështje ka të bëjë me krijimin e një klime të sigurtë për investimet në Shqipëri edhe është në linjë me angazhimet e marra në këtë fushë.

VENDIM

Nr. 129, datë 22.2.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA E MADHE E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe 34 188.8 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetë) m², me vlerë 167 869 732 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë, objekte me vlerë 13 965 786 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 585 000 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, të përballohen nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitin 2012.

6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVRPP-së” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të jepet konfirmim nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për sipërfaqet e regjistruara, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që ata do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Pronarët e objekteve, për të cilat janë bërë shënimet “Leje legalizimi” dhe “Proces kualifikimi nga ALUIZNI”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuadojë pronarët, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pronarët e pasurive të shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS “UNAZA E MADHE TIRANË”
SEGMENTI: “KOMUNA E PARISIT- RRUGA E RE, TIRANË ELBASAN”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pas.	Sipërfaqet			Objekte	Vlera Totale, lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			m ²	Çmimi	Vlera në lekë			
1	B/Pronarët Kika			3292	100/49	530	8527.5	4,519,575		4,519,575	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	14 B/P Kika			3292	100/30	3400	8527.5	28,993,500		28,993,500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Bajame		Alla	8270					8127568	8,127,568	Proces kualifikimi nga ALUIZNI
4	B/P Pinari			8270	8/441	223	8527.5	1,901,633		1,901,633	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Haki		Pinari	8270	8/337	164	8527.5	1,398,510		1,398,510	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Sadri		Pinari	8270	8/428	250	8527.5	2,131,875		2,131,875	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Haki		Pinari	8270	8/429	280	8527.5	2,387,700		2,387,700	Rikonfirmim
8	Haki		Pinari	8270	8/512	35	8527.5	298,463		298,463	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Sabri		Pinari	8270	8/330	800	8527.5	6,822,000		6,822,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Sabri		Pinari	8270	8/439	231	8527.5	1,969,853		1,969,853	Rikonfirmim
11	Ymer		Brari	8270	8/693	40	8527.5	341,100		341,100	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Diamant		Ali	8270	8/694	35	8527.5	298,463		298,463	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Drita		Shpendi	8270	8/258	52	8527.5	443,430		443,430	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Enver		Brari	8270	8/170	30	8527.5	255,825		255,825	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	B/P Balla, Selimaj, Stafa			8280	1/114	487.5	8527.5	4,157,156		4,157,156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Naim		Balla	8280	1/115	487.5	8527.5	4,157,156		4,157,156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Ismail		Balla	8280	1/116	282	8527.5	2,404,755		2,404,755	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	3 B/P Balla			8280	1/111	487.5	8527.5	4,157,156		4,157,156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	B/P Balla, Kole, Teqja			8280	1/112	487.5	8527.5	4,157,156		4,157,156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Bedrie		Guzja	8280	1/113	487.5	8527.5	4,157,156		4,157,156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	B/P Caka, Kuka, Brahja			8280	1/110	1279	8527.5	10,906,673		10,906,673	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Florian		Bodinaku	8280	1/124	212	8527.5	1,807,830		1,807,830	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Fatos		Bodinaku	8280	1/125	436	8527.5	3,717,990		3,717,990	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Pranvera Bodinaku			8280	1/126	477	8527.5	4,067,618		4,067,618	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	B/Pronarët Bodinaku			8280	1/109	75.32	8527.5	642,291		642,291	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	B/P Bodinaku			8280	1/130	210	8527.5	1,790,775		1,790,775	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

27	Roland		Bodinaku	8280	1/127	422	8527.5	3,598,605		3,598,605	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Yllbardh		Bodinaku	8280	1/128	422	8527.5	3,598,605		3,598,605	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	Gani		Bodinaku	8280	1/129	422	8527.5	3,598,605		3,598,605	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	11 B/P Xibri, Brahja			8280	1/73	501	8527.5	4,272,278		4,272,278	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	Shyqyri		Garunja	3266	96/10	509	2622.165	1,334,682		1,334,682	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	Petro		Gjergji	3266	96/28	577	2622.165	1,512,989		1,512,989	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	Petrit, Neptun Pollo			3266	96/36	116	2622.165	304,171		304,171	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	Sherif		Brahja	3266	96/38	76	2622.165	199,285		199,285	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	Trshg. Brahja			3266	94/1/4	796	2622.165	2,087,243		2,087,243	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Selim		Brahja	3266	94/1/5	414	2622.165	1,085,576		1,085,576	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	Flamur		Brahja	3266	93/1/5	1000	2622.165	2,622,165		2,622,165	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	Trshg. Brahja			3266	93/1/3	1000	2622.165	2,622,165		2,622,165	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	Lulzim		Brahja	3266	93/1/6	992	2622.165	2,601,188		2,601,188	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	Skënder		Brahja	3266	93/1/7	631	2622.165	1,654,586		1,654,586	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	Selim		Brahja	3266	93/1/4	278	2622.165	728,962		728,962	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	Kreshnik		Brahja	3266	88/2/9	49	2622.165	128,486		128,486	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	Haxhi		Balliu	3266	88/16	2336	2622.165	6,125,377		6,125,377	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	Haxhi		Balliu	3266	88/15	116	2622.165	304,171		304,171	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	Enver Albana		Xhaja Ksuliobani	3266	86/3	4638	2622.165	12,161,601		12,161,601	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	Altin		Lala	3266	7/94	102	2622.165	267,461		267,461	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	Hasan		Muca	3266	7/1/29	1407	2622.165	3,689,386		3,689,386	Rikonfirmim
48	Astrit	Qamil	Laci	3266	75/79	459	2622.165	1,203,574	5838218	7,041,792	Rikonfirmim/Objekti me leje legalizimi
49	Fatmir		Lela	3266	86/16	92	2622.165	241,239		241,239	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Kasem		Brahja	3266	84/2/3	3611	2622.165	9,468,638		9,468,638	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	Nexhmi		Brahja	3266	84/2/2	994	2622.165	2,606,432		2,606,432	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	Zenel	Rustem	Hajdari	3266	16/1	750	2622.165	1,966,624		1,966,624	Rikonfirmim
	TOTALI					34188.8		167,869,732	13965786	181,835,518	

VENDIM
Nr. 131, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE-SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore-Shkodër.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 104 369 670 (njëqind e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 1 547 500 (një milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 104 369 670 (njëqind e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh të përballohen nga buxheti i vitit 2012, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve zëri “Investime”.
6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2012.
7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja” Shkodër, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procedura e regjistrimit, si dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në përputhje me vendimin nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja Shkodër”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, pasi pronarët të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit, si dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
12. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, në përputhje me vendimin nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave.
13. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

14. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
OBJEKTET E NDËRTIMIT QË SHPRONËSOHEN PAS NDRYSHIMIT TË PROJEKTIT TE SEGMENTIT RRUGOR
“UNAZA LINDORE SHKODËR”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Objekte ndërtimi

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Vlera në lekë sipas preventivit		Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Lloji i objektit		
1	Qemal		Suma	8597		3,412,454	Shtëpi	Proces legalizimi
2	Lirim		Qahi	8597		859,768	Dyqan	Proces legalizimi
3	Edmir		Ramadani	8597		1,319,325	Dyqan	Proces legalizimi
4	Eliaz		Alushi	8597		775,804	Dyqan	Proces legalizimi
5	Idriz		Ishmaku	8597	3/8 + 1-1, 3/8 + 1-1	6,854,047	Shtëpi	Proces regjistrimi
6	Musa		Dyli	8597	7/59	1,260,575	Repart zdrukthëtarie	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Faik		Hykaj	8594		427,652	Mur rrethues	Proces legalizimi
8	Fejzi		Zogani	8594		94,289	Mur rrethues	Proces legalizimi
9	Gege		Vata	8594		719,124	Dyqan	Proces legalizimi
10	Mark		Fierza	8594		2,392,338	Shtëpi	Proces legalizimi
11	Vuksan		Marku	8594		654,822	Dyqan	Proces legalizimi
12	Dede		Guri	8594		957,314	Dyqan	Proces legalizimi
13	Edmond		Leka	8593		1,719,552	Dyqan	Proces legalizimi
14	Gezim		Begaj	8593		326,195	Dyqan	Proces legalizimi
15	Gjon		Kolnikaj	8593	12/12	1,701,058	Objekt në ndërtim	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Hektor		Kapaklija	8593	11/320	1,765,659	Dyqan	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Pal		Ballfusha	8593		1,795,176	Banesë	Proces legalizimi
18	Pashk		Nika	8593		2,482,610	Lokal	Proces legalizimi
19	Pëllumb		Lufaj	8593		206,554	Rrethim	Proces legalizimi
20	Pjerrin		Verri	8593		2,218,257	Banesë	Proces legalizimi
21	Gjergji		Podja	8593		497,314	Mur rrethues	Proces legalizimi
22	Rrok		Lumaj	8593		663,084	Mur rrethues	Proces legalizimi
23	Shaqe		Tollozi	8593		3,346,720	Banesë	Proces legalizimi
24	Vat		Arra	8593		733,223	Dyqan	Proces legalizimi
25	Aleksandër Zef		Pjetri	8593		220,600	Mur rrethues	Proces legalizimi
26	Fran		Kroni	8593		3,311,525	Furrë buke	Proces legalizimi
27	Gjon		Leka	8593		104,903	Mur rrethues	Proces legalizimi
28	Paulin		Gështenja	8593		97,098	Mur rrethues	Proces legalizimi
29	Gjin		Krepi	8593		1,250,136	Dyqan	Proces legalizimi
30	Mark		Kollaj	8593		847,915	Dyqan	Proces legalizimi
31	Sokol		Kroni	8593		4,064,426	Dyqan	Proces legalizimi
32	Zef		Pjetri	8593		730,298	Dyqan	Proces legalizimi
33	Arben	Xhevat	Halluni	8592	12/155	1,597,116	Dyqan	Konfirmuar nga ZVRPP
34	Besim		Curri	8592		1,546,480	Dyqan	Proces legalizimi
35	Edmond		Ndou	8592		461,648	Lokal	Proces legalizimi
36	Hajredin		Vajoshi	8592	8/2	385,013	Rrethim	Proces regjistrimi
37	Lazer		Beka	8592		5,185,705	Banesë	Proces legalizimi
38	Luigj		Toma	8592		4,815,155	Banesë	Proces legalizimi
39	Rrok		Neziraj	8592		123,710	Rrethim	Proces legalizimi
40	Xhevahire		Mesi	8592	8/1	2,058,260	Banesë	Proces regjistrimi
41	Agron		Memaçi	8592		3,004,451	Dyqan	Proces legalizimi

42	Ismet		Balaj	8592		1,140,680	Shtëpi	Proces legalizimi
43	Skënder		Kraja	8592	8/316	2,711,562	Shtëpi	Konfirmuar nga ZVRPP
44	Ernest		Gjuraj	8593	8/257	1,418,066	Banesë	Konfirmuar nga ZVRPP
45	Besnik		Alija	8592	12/249	3,324,896	Banesë	Konfirmuar nga ZVRPP
46	Isa		Milla	8592	12/7	920,786	Banesë	Proces regjistrimi
47	Ragip		Selmani	8597	10/109	3,958,903	Karburant	Proces regjistrimi
48	Alfons		Cico	8593	8/31	10,256,870	Depo	Proces regjistrimi
49	Gjon		Lajthia	8593	8/205	6,882,323	Depo	Konfirmuar nga ZVRPP
50	Paulin		Radovani	8593	8/294	296,851	Mure rrethues	Proces regjistrimi
51	Mark		Xhani	8593	9/25	135,316	Mure rrethues	Proces regjistrimi
52	Shaqir		Tyrbetari	8592	8/317	216,200	Mure rrethues + shesh	Proces regjistrimi
53	Saimir		Mehja	8597		3,898,315	Ndërtesë 2kt	Proces legalizimi
54	Aleksandër		Kelaj	8593		642,765	Dyqan, mur rrethues	Proces legalizimi
55	Mire		Lugjeja	8593		527,630	Mure rrethues	Proces legalizimi
56	Ragip	Selman	Selmani	8597		1,051,154	Aneks banese 1kt	Proces legalizimi
		TOTALI				104,369,670		

VENDIM
Nr. 132, datë 22.2.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË) QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN-VLORË (SEKSIONI I PARË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajshme, pronë private (kultura bujqësore dhe dru frutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë).
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet sipas listave bashkëlidhur, për kultura bujqësore me vlerë 3 093 255 (tre milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, dru frutorë me vlerë 3 304 769 (tre milionë e treqind e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 705 000 (një milion e shtatëqind e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh, të përballohen nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve për vitin 2012.
6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.
7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Pronarët e pasurive, për të cilët në kolonën respektive është bërë shënimi “Të pakonfirmuar” dhe “Proces saktësimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë bërë regjistrimet apo të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme Fier dhe pasi të jenë konfirmuar të dhënat e plota e të sakta po nga kjo zyrë lidhur me titullin e pronësisë.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7 dhe 8 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "LEVAN-VLORË"
PËR KULTURAT: BIMË ARASH DHE DRU FRUTORË

Fshatrat: Levan dhe Ferras, komuna Levan, Rrethi Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e shpronësuar m ²	Vlera, lekë bimë arash	Vlera lekë, dru frutorë	Totali lekë	Shënime
1	Syrja	Nurçe	Licaj	2436	7/1	1383		1269900	1269900	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Asqeri	Syrja	Licaj	2436	7/2	1084		996000	996000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Skënder	Syrja	Licaj	2436	7/3	810		747000	747000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Rustem	Nurçe	Lili	2436	7/4	1667	29172		29172	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Klerko	Jorgji	Nerenxa	2436	7/5	802	4812		4812	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Besnik	Tefik	Bregu	2436	7/6	2489	38331		38331	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Fatmir	Tefik	Bregaj	2436	7/7	1185	18249		18249	Konfirmuar nga ZRPP-ja
8	Roland	Tefik	Bregaj	2436	7/8	853	13136		13136	Konfirmuar nga ZRPP-ja
9	Agron	Brahim	Guri	2436	7/9	2318	35697		35697	Konfirmuar nga ZRPP-ja
10	Line	Besim	Bidaj	2436	7/10	1731	26657		26657	Konfirmuar nga ZRPP-ja
11	Bashkim	Qemal	Zykaj	2436	7/11	1059	16863		16863	Konfirmuar nga ZRPP-ja
12	Sulo	Myslym	Lamce	2436	7/12	1809	31656		31656	Konfirmuar nga ZRPP-ja
13	Lefter	Myslym	Lamce	2436	7/13	1608	28140		28140	Konfirmuar nga ZRPP-ja
14	Mensur	Avni	Cuni	2436	7/14	738	4428		4428	Konfirmuar nga ZRPP-ja
15	Flamur	Myslym	Lamce	2436	7/15	959	5754		5754	Konfirmuar nga ZRPP-ja
16	Almon	Myslym	Lamce	2436	7/16	2032	12192		12192	Konfirmuar nga ZRPP-ja
17	Astrit	Myslym	Lamce	2436	7/17	1359	8154		8154	Konfirmuar nga ZRPP-ja
18	Rakip	Ali	Kocaj	2436	7/18	1924	40404		40404	Konfirmuar nga ZRPP-ja
19	Pajtim	Isuf	Naskaj	2436	7/19	1721	17210		17210	Konfirmuar nga ZRPP-ja
20	Nazmi	Tefik	Zykaj	2436	7/22	699	6990		6990	Konfirmuar nga ZRPP-ja
21	I papërcaktuar			2436	7/24:7/25	2516	25160		25160	Proces saktësimi
22	Zoi	Vasil	Marku	2436	120/7	805	12397		12397	Konfirmuar nga ZRPP-ja
23	Mina	Vasil	Marku	2436	120/8	1068	16447		16447	Konfirmuar nga ZRPP-ja
24	Filip	Vasil	Marku	2436	120/9	1014	15616		15616	Konfirmuar nga ZRPP-ja
25	Leonard	Vasil	Marku	2436	120/10	1644	25318		25318	Konfirmuar nga ZRPP-ja
26	Ilia	Vasil	Marku	2436	120/11	1959	30169		30169	Konfirmuar nga ZRPP-ja
27	Josif	Muzak	Kongjonaj	2436	120/12	860	18060		18060	Konfirmuar nga ZRPP-ja
28	Llazi	Jani	Marku	2436	120/13	1566	24116		24116	Konfirmuar nga ZRPP-ja
29	Stavri	Jani	Marku	2436	120/14	1863	28690		28690	Konfirmuar nga ZRPP-ja
30	Harilla	Jani	Marku	2436	120/15	1810	27874		27874	Konfirmuar nga ZRPP-ja
31	Vangjel		Marku	2436	120/16	1378	26528		26528	Konfirmuar nga ZRPP-ja
32	Josif	Jani	Marku	2436	120/17	2100	36750		36750	Konfirmuar nga ZRPP-ja
33	Gori	Kristo	Shindre	2436	120/18	1878	28910		28910	Konfirmuar nga ZRPP-ja
34	Dhimo		Puriqi	2436	120/19	591	10342		10342	Konfirmuar nga ZRPP-ja
35	Suzana		Subshaj(B)	2436	121/11	229	3500		3500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
36	Sulo	Besho	Sulaj	2436	121/14	867	13352		13352	Konfirmuar nga ZRPP-ja
37	Selam	Vesel	Sulaj	2436	121/15	1330	20482		20482	Konfirmuar nga ZRPP-ja
38	Banush	Vesel	Sulaj	2436	121/16	1533	23608		23608	Konfirmuar nga ZRPP-ja
39	Krenar	Skender	Sulaj	2436	121/19	2877	60417		60417	Konfirmuar nga ZRPP-ja
40	Rushan	Skender	Sulaj	2436	121/20	3162	66402		66402	Konfirmuar nga ZRPP-ja
41	Veip	Skender	Sulaj	2436	121/21	3487	53699		53699	Konfirmuar nga ZRPP-ja
42	Kastriot	Skender	Sulaj	2436	121/22	3233	67893		67893	Konfirmuar nga ZRPP-ja
43	Astrit		Sulaj	2436	121/23	2973	52027		52027	Konfirmuar nga ZRPP-ja
44	Zenel	Bektash	Lamce	2436	121/24	3401	59517		59517	Konfirmuar nga ZRPP-ja
45	Bektash		Lamce	2436	121/25	1544	27020		27020	Konfirmuar nga ZRPP-ja
46	Etmond	Jani	Cobani	2436	121/26	2956	51730		51730	Konfirmuar nga ZRPP-ja
47	Shkëlqim	Qemal	Lamce	2436	121/27	5076	88830		88830	Konfirmuar nga ZRPP-ja
48	Hekuran		Lamce	2436	121/28	3043	58572		58572	Konfirmuar nga ZRPP-ja
49	Napolon	Bektash	Lamce	2436	121/29	693	12127		12127	Konfirmuar nga ZRPP-ja
50	Xhemal	Riza	Hoxhaj	2436	121/30	94	1645		1645	Konfirmuar nga ZRPP-ja
51	Alim	Tefik	Braka	2436	122/2	3586	28688		28688	Konfirmuar nga ZRPP-ja
52	Petra	Rakip	Bocova	2436	122/3	4636	97356		97356	Konfirmuar nga ZRPP-ja
53	Mikail		Kristo	2436	122/5	1885	26390		26390	Konfirmuar nga ZRPP-ja
54	Jorgji	Koli	Baka	2436	122/7	2223	46683		46683	Konfirmuar nga ZRPP-ja
55	Albert	Jorgji	Baka	2436	122/8	2743	57603		57603	Konfirmuar nga ZRPP-ja
56	Sokrat		Baka	2436	122/9	2596	54516		54516	Konfirmuar nga ZRPP-ja
57	Spiro	Josif	Baka	2436	122/10	2138	44898		44898	Konfirmuar nga ZRPP-ja
58	Dhimitra		Baka	2436	122/11	2258	47418		47418	Konfirmuar nga ZRPP-ja
59	Thoma	Josif	Baka	2436	122/12	962	20202		20202	Konfirmuar nga ZRPP-ja

60	Landi		Baka	2436	122/13	839	17619		17619	Konfirmuar nga ZRPP-ja
61	Aleksandër		Llambro	2436	122/14	649	13629		13629	Konfirmuar nga ZRPP-ja
62	Llukan		Kristo	2436	122/38	3640	27300		27300	Konfirmuar nga ZRPP-ja
63	Sokrat		Kristo	2436	122/39	545	7630		7630	Konfirmuar nga ZRPP-ja
64	Tefta		Grabovaj(B)	2436	123/26	3260	50204		50204	Konfirmuar nga ZRPP-ja
65	Musa		Veli	2436	127/6	330	33000		33000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
66	Jemin	Muhamet	Veli	2436	127/7	312	31200		31200	Konfirmuar nga ZRPP-ja
67	Naile	Mehmet	Jaupi	2436	127/8	260	26000		26000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
68	Nazar	Muhamet	Veli	2436	127/9	394	39400		39400	Konfirmuar nga ZRPP-ja
69	Sherif		Rustemi	2436	127/10	383	38300		38300	Konfirmuar nga ZRPP-ja
70	Rushit	Hizer	Bibo	2436	127/14	561	9817		9817	Konfirmuar nga ZRPP-ja
71	Fejzi	Riushit	Bibo	2436	127/15	276	4830		4830	Konfirmuar nga ZRPP-ja
72	Shyqyri	Sefedin	Malaj	2436	127/16	441	7717		7717	Konfirmuar nga ZRPP-ja
73	Skënder	Isa	Tana	2436	130/4	1993	34877		34877	Konfirmuar nga ZRPP-ja
74	Liko		Binjaku	2436	129/23	797	79700		79700	Konfirmuar nga ZRPP-ja
75	Mina	Nasto	Binjaku	2436	129/24	513	51300		51300	Konfirmuar nga ZRPP-ja
76	Stavri		Kordha	2436	129/25	171	17100		17100	Konfirmuar nga ZRPP-ja
77	Ismet		Cobo	2436	141/1	142		46950	46950	Konfirmuar nga ZRPP-ja
78	Shezai	Hysni	Cobo	2436	141/2;144/2	998	20958		20958	Konfirmuar nga ZRPP-ja
79	Astrit		Cobo	2436	141/3	424	20352		20352	Konfirmuar nga ZRPP-ja
80	Tajar		Cobo	2436	142/1	844	14770	87500	102270	Konfirmuar nga ZRPP-ja
81	Nazmi		Cobo	2436	143/1	808	80800	18000	98800	Konfirmuar nga ZRPP-ja
82	Shezai		Cobo	2436	144/1	452		77608	77608	Konfirmuar nga ZRPP-ja
83	Zakie		Cobo	2436	141/5	340		19611	19611	Konfirmuar nga ZRPP-ja
84	Servet		Caushi	2436	412/13	24		3000	3000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
85	Nazmi		Ahmetaj	2436	412/14	690	5175	13000	18175	Konfirmuar nga ZRPP-ja
86	Ramiz		Zyka	2436	412/16	2478	18585		18585	Konfirmuar nga ZRPP-ja
87	Bafjjar		Veizaj	2436	412/17	1969	14767		14767	Konfirmuar nga ZRPP-ja
88	Nezir		Veizaj	2436	412/18	3070	23025		23025	Konfirmuar nga ZRPP-ja
89	Adil		Veizaj	2436	412/19	1493	11212		11212	Konfirmuar nga ZRPP-ja
90	Enver		Balla	2436	412/20	250	1875		1875	Konfirmuar nga ZRPP-ja
91	Skënder		Caushaj	2436	412/25	367	2752		2752	Konfirmuar nga ZRPP-ja
92	Gjolek		Caushaj	2436	412/26	703	5272		5272	Konfirmuar nga ZRPP-ja
93	Durim		Caushaj	2436	412/27	679	5092		5092	Konfirmuar nga ZRPP-ja
94	Arjan	Luci	Rezhda	2436	538/1	454	2724		2724	Konfirmuar nga ZRPP-ja
95	Elida	Tomci	Naci	2436	538/4	204	1224		1224	Konfirmuar nga ZRPP-ja
96	Sabah	Jakup	Mucaj	2436	538/5	1001	6006		6006	Konfirmuar nga ZRPP-ja
97	Tomorr	Bajram	Rrapaj	2436	538/6	290	1740		1740	Konfirmuar nga ZRPP-ja
98	Myqerem	Bektash	Kazanxhi	2436	538/8	1063	6378		6378	Konfirmuar nga ZRPP-ja
99	Maliq	Ramadan	Myrteli	2436	538/9	589	3534		3534	Konfirmuar nga ZRPP-ja
100	Mynyr	Riza	Tushollari	2436	538/10	777	4662		4662	Konfirmuar nga ZRPP-ja
101	Fadil	Riza	Tushollari	2436	538/11	838	5028		5028	Konfirmuar nga ZRPP-ja
102	Kovac	Riza	Tushollari	2436	538/12	764	4584		4584	Konfirmuar nga ZRPP-ja
103	Myqerem	Zyber	Hamzo	2436	538/13	920	5520		5520	Konfirmuar nga ZRPP-ja
104	Laver	Bexhet	Myrteli	2436	538/14	970	5820		5820	Konfirmuar nga ZRPP-ja
105	Halit	Zyber	Hamza	2436	538/15	863	5178		5178	Konfirmuar nga ZRPP-ja
106	Pilo	Nazif	Myrteli	2436	538/16	646	3876		3876	Konfirmuar nga ZRPP-ja
107	Rrapi	Rexhep	Kalemaj	2436	538/17	1201	7206		7206	Konfirmuar nga ZRPP-ja
108	Osman	Rrapi	Mersini	2436	538/18	1027	6162		6162	Konfirmuar nga ZRPP-ja
109	Ramadan	Rrapi	Mersini	2436	538/19	906	5486		5486	Konfirmuar nga ZRPP-ja
110	Agim	Shefqet	Zeqiraj	2436	538/20	568	3408		3408	Konfirmuar nga ZRPP-ja
111	Vladimir	Qazim	Mersini	2436	538/21	529	3174		3174	Konfirmuar nga ZRPP-ja
112	Fatime		Hoxhaj	2436	538/51	1233	7398		7398	Konfirmuar nga ZRPP-ja
113	Qazim		Mersini	2436	538/22	522	3132		3132	Pakonfirmuar
114	Enver	Shefqet	Tushollari	2436	538/23	171	1026		1026	Konfirmuar nga ZRPP-ja
115	Lefter	Shefqet	Tushollari	2436	538/24	175	1050		1050	Konfirmuar nga ZRPP-ja
116	Agron	Shefqet	Tushollari	2436	538/26	255	1530		1530	Konfirmuar nga ZRPP-ja
117	Shefqet	Riza	Tushollari	2436	538/27	43	258		258	Konfirmuar nga ZRPP-ja
118	Vangjel		Kushi	2436	538/40	1204	12040		12040	Konfirmuar nga ZRPP-ja
119	I pidentifikuar			2436	538/41	1038	10380		10380	Pakonfirmuar
120	Rako		Nako	2436	538/42	1153	11530		11530	Konfirmuar nga ZRPP-ja
121	Leonard	Rako	Nako	2436	538/43	1215	12150		12150	Konfirmuar nga ZRPP-ja
122	Agron	Rako	Nako	2436	538/44	841	8410		8410	Konfirmuar nga ZRPP-ja
123	Vladimir	Ismail	Kamberaj	2436	538/45	1178	11780		11780	Konfirmuar nga ZRPP-ja
124	Arben	Ismail	Kamberaj	2436	538/46	872	8720		8720	Konfirmuar nga ZRPP-ja
125	Agim	Ismail	Kamberaj	2436	538/47	1442	14420		14420	Konfirmuar nga ZRPP-ja
126	Rabie	Shefit	Kamberaj	2436	538/48	1156	11560		11560	Konfirmuar nga ZRPP-ja
127	Sokolesha	Jashar	Kamberaj	2436	538/49	917	9170		9170	Konfirmuar nga ZRPP-ja
128	Virjon	Petro	Prifti	2436	538/50	1228	12280		12280	Konfirmuar nga ZRPP-ja
129	Qemal	Shefit	Hoxhaj	2436	538/52	1498	14980		14980	Konfirmuar nga ZRPP-ja
130	Afërdita	Ymer	Bregu	2436	538/53	1509	15090		15090	Konfirmuar nga ZRPP-ja
131	Aristidh		Sema	1609	23/34	2194	21920		21920	Konfirmuar nga ZRPP-ja
132	Spiro	Loni	Sema	1609	43/10	3276	57330		57330	Konfirmuar nga ZRPP-ja
133	Kozma		Sema	1609	43/11	307	3080		3080	Konfirmuar nga ZRPP-ja
134	Vangjel		Sema	1609	43/12	5840	102200		102200	Konfirmuar nga ZRPP-ja
135	Arsini		Sema	1609	43/13	1573	27527		27527	Konfirmuar nga ZRPP-ja
136	Ndoni		Petani	1609	44/2	690	10630		10630	Konfirmuar nga ZRPP-ja
137	Sokrat		Petani	1609	44/3	6361		20500	20500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
138	Kristaq	Sotir	Petani	1609	44/4	1715	26425		26425	Konfirmuar nga ZRPP-ja
139	Kristaq		Nako	1609	45/4	2400		5700	5700	Konfirmuar nga ZRPP-ja
140	Parashqevi		Sema	1609	221/6	3589	62807		62807	Konfirmuar nga ZRPP-ja
141	Vasil		Sema(B)	1609	221/7	3981	69667		69667	Konfirmuar nga ZRPP-ja
			Totali				3093255	3304769	6398024	

VENDIM
Nr. 133, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE) QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR QUKËS-QAFË-PLLOÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Plloçë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 225 000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2012, zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.
 6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.
 7. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të likuidohet, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procesi i regjistrimit, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Librazhd, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmohet nga ZVRPP-ja”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 9. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Proces legalizimi”, do të likuidohet, për efekt shpronësimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.
 10. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, do të likuidohet, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor që do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, në bazë të pikave 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“QUKËS-QAFË-PLLOÇË” LOTI I

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri i pasurisë	Objekt lloji	Shuma totale (lekë)	Shënime
1	Agim	Sali	Leka	3120	443/40	Karabina	957519.7	Proces Legalizimi
2	Avni	Sabri	Kocoli	1169	1088/4	Shesh	246244.8	Leje ndërtimi
3	Shaban	Maksut	Gega	1169	1064/3	Shtëpi Banimi	2644136	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Hasan	Maksut	Gega	1169	1064/2	Shtëpi Banimi	3043630	Proces regjistrimi
		TOTALI					6891530.5	

VENDIM
Nr. 134, datë 22.2.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR INSTITUTIN E STATISTIKAVE, PËR ORGANIZIMIN DHE ZBATIMIN E REGJISTRIMIT TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institutit të Statistikave, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi me shumën 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë, për shpenzime për paga personeli (anketues) për organizimin dhe zbatimin e projektit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore.
2. Efekti financiar të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, të miratuar për vitin 2012.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 135, datë 22.2.2012

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRIVE
“HEC ULËZ-SHKOPET” SHA DHE “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë Lanabregas”, sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të jetë si më poshtë vijon:

a) Për mbulimin nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të shpenzimeve për realizimin e procedurave të tenderimit për shitjen e aksioneve të këtyre shoqërive.

b) Pjesa e mbetur të derdhet në Buxhetin e Shtetit.

2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 22.3.2012
Doli nga shtypi më 24.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë